




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, tel.0280 320 781, 0280 320 782, 0280 321 482, 0280 321 486

DATE/A:	06 .04.2012
REFERENC-Ë:	Zyrtare
PËR/ZA/TO:	Z. Ramë Buja, Ministër i Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, z. Bedri Hamza, Ministër i Ministrisë për Financa,
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izmi ZEKA, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjilanit
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Rekomandimi i KK-Gjilan rreth Kërkesës së arsimtarëve të Komunës së Gjilanit për kompensimin e të ardhurave personale

Të nderuar Ministra,

Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 06.04.2012, ka shqyrtuar kërkesën e grupit të arsimtarëve të Komunës së Gjilanit e cila ka të bëjë me kompensimin e të ardhurave personale të arsimtarëve të cilët ishin kandidatë të mundshëm për anëtarë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit në zgjedhjet lokale të vitit 2007, pasi të njëjtit kanë punuar dhe kanë mbajtur procesin mësimor në shkollat e tyre përkatëse gjatë fushatës parazgjedhore, në mungesë të zëvendësimit të tyre, dhe se të njëjtit nuk kanë pasur njoftim paraprak se nuk kanë të drejtë të punojnë gjatë fushatës parazgjedhore.

Kuvendi i Komunës së Gjilanit pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe debatit nga anëtarët e kuvendit dhe në pamundësi të plotësimit dhe realizimit të kërkesës së arsimtarëve të Komunës së Gjilanit, unanimisht nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I Rekomandohet Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji dhe Ministrisë për Financa që të shqyrtoj kërkesën e arsimtarëve të komunës së Gjilanit për kompensimin e të ardhurave personale të punëtorëve të arsimit të cilët kanë punuar gjatë fushatës parazgjedhore në zgjedhjet lokale të vitit 2007, dhe që të njëjtit nuk kanë pasur njoftim paraprak se nuk kanë të drejtë të punojnë, e në anët tjetër kanë qenë të larguar nga listat e pagave

P.S. Bashkangjitur këtij akti po ju dërgojmë Kërkesën dhe Listën me emrat e arsimtarëve të cilët kërkojnë kompensimin e të ardhurave personale,

Me respekt!